



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

Nr. 1057 prot.

Tiranë, më, 17.07.2024

V E N D I M

Nr.2, datë 15.7.2024

PËR

**“MIRATIMIN E HARTAVE TË RREZIKUT NGA PËRMBYTJET PËR TERRITORIN E ZONAVE KU EKZISTON RREZIKU POTENCIAL NGA PËRMBYTJET OSE KA GJASA TË NDODHIN PËRMBYTJE, TË SHPALLURA, DRIN-BUNË 1, 2, 3, 4, 7, 8; ISHËM 1, 2, 3; ERZEN 1, 2, 3, 4, 5, 6; SHKUMBIN 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8; SEMAN 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 DHE VJOSË 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8; SI EDHE HARTAT E RISKUT PËR ZONAT ISHËM 1, 2, 3; ERZEN 1, 2, 3, 4, 5, 6; SHKUMBIN 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8; SEMAN 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 DHE VJOSË 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.”**

Në mbështetje të Kreut 2, të Shtojcës III, të Vendimit nr.1015, datë 16.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të burimeve ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet”, paragrafit “vii”, të shkronjës “b”, të pikës 1, të kreut III, të Vendimit nr.221, datë 26.4.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Miratimin e hartave të rrezikut nga përmbytjet për zonat ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin përmbytje, të shpallura, Drin-Bunë 1, 2, 3, 4, 7 dhe 8, Ishëm 1, 2 dhe 3, Erzen 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6, Shkumbin 1, 2, 3, 4,

- 5, 6, 7 dhe 8, Seman 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11, Vjosë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Miratimin e hartave të rrezikut nga përmbytjet, të cilat konsiderojnë ndryshimet klimatike, për zonat ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin përmbytje, të shpallura, Erzen 1, Erzen 5 dhe Erzen 6, Ishëm 2 dhe Ishëm 3, Shkumbin 2 dhe Shkumbin 4, Vjosa 1 dhe Vjosa 3, sipas aneksit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
  3. Miratimin e hartave të riskut nga përmbytjet për zonat ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin përmbytje, të shpallura, Ishëm 1, 2 dhe 3, Erzen 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6, Shkumbin 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8, Seman 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11, Vjosë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8, si edhe legjenda e elementëve të ndikuar, sipas aneksit 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
  4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, që hartat të vendosen në faqen e internetit të AMBU-së dhe të jenë të disponueshme për publikun.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**BELINDA BALLUKU**

**AGJENCIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE**

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**GERTA LUBOASA**